

Studimet e larta dhe Universiteti

Në Zvicër, ka dy lloje Shkollash të Larta: Universitetet dhe Hautes écoles spécialisées (HES) (Shkollat e Larta të Specializuara (HES)). Të gjitha Shkollat e Larta ndjekin sistemin e Bolonjës: sistemi evropian i arsimit të lartë. Është e mundur gjithashtu të ndiqen studimet e larta në formën e formimit të vazhdueshëm.

Sistemi i Shkollave të Larta

Shkollat e larta zvicerane ndahen në Universitete dhe Shkolla të Larta të Specializuara. Në Shkollat e Larta, mësimi është i orientuar drejt praktikës, në Universitete ai është më shumë teorik dhe akademik.

Të dyja llojet e shkollave kanë të njëjtën vlerë. Ato ndjekin sistemin e Bolonjës, sistemi evropian i arsimit të lartë. Në fund të studimeve, studentët marrin një diplomë të njohur në gjithë Evropën: Bachelor (rreth 3 vite studimi) dhe më pas Master (rreth 2 vite studimi).

Pranimi në një Shkollë të Lartë

Me një diplomë mature zvicerane, hyrja në Shkollat e Larta është e garantuar.

Certifikatat e huaja të përfundimit të studimeve nuk njihen automatikisht.

Duhet të regjistroheni drejtpërdrejt në Shkollën e Lartë, në të cilën doni të studioni.

Kushtet e pranimit janë të ndryshme sipas Shkollave të Larta.

Për shembull, disa Shkolla të Larta kërkojnë dhënien e disa provimeve ose kryerjen e stazheve.

Në përgjithësi, janë të nevojshme njohuri shumë të mira të frëngjishtes ose të gjermanishtes. Përveç studimeve që zhvillohen tërësisht në anglisht.

Centre d'orientation scolaire et professionnelle et de psychologie scolaire (COSP)

(Qendra e orientimit shkollor dhe profesional dhe e psikologjisë shkollore (COSP))

informon falas mbi mundësitë e ndryshme të studimeve në Shkollat e Larta.

Arsimi profesional i lartë

Krahas Hautes écoles (HES) (Shkollave të Larta të Specializuara (HES)), ekzistojnë edhe Ecoles supérieures (ES) (Shkollat e Larta (ES)).

Në këto shkolla, profesionistët, që kanë një certifikatë profesionale të aftësisë (CFC), mund të marrin një diplomë ES. Kjo diplomë është e të njëjtit nivel me një diplomë HES, por është më praktike dhe e orientuar drejt profesionit.

Formimi i vazhdueshëm

Profesionistët mund të specializohen dhe të thellojnë njohuritë e tyre profesionale duke ndjekur një formim të vazhdueshëm. Ata mund të marrin diploma, si Diploma federale ose Certifikata Profesionale Federale.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/studimet-e-larta-dhe-universiteti